



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 34

15 mars

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i BSH nr. 15, datë 13.2.2013	Për miratimin e rregullores “Për kontrollin për autenticitet dhe kriteret e riciklimit të kartëmonedhave shqiptare” 1393
Vendim i BSH nr. 17, datë 13.2.2013	Për shtyrjen e afatit të këmbimit të disa kartëmonedhave pa kurs ligjor 1410

VENDIM
Nr. 15, datë 13.2.2013

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KONTROLLIN PËR AUTENTICITET DHE
KRITERET E RICIKLIMIT TË KARTËMONEDHAVE SHQIPTARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a”, nenit 43 shkronja “c” dhe kreut V të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me propozimin e Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për kontrollin për autenticitet dhe kriteret e riciklimit të kartëmonedhave shqiptare”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Emisionit në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
PËR KONTROLLIN PËR AUTENTICITET DHE KRITERET E RICIKLIMIT TË
KARTËMONEDHAVE SHQIPTARE

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kritereve për kontrollin për autenticitet, vlerësimin e përshtatshmërisë për qarkullim dhe riciklimin e kartëmonedhave lek.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- a) nenit 12 shkronja “a”, nenit 43 shkronja “c” dhe kreut V të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- b) ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhet “ligji për bankat”.



Neni 3 Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë, si dhe klientët e tjerë me status të veçantë që kryejnë veprime në *cash* me Bankën e Shqipërisë.

Neni 4 Përkufizime

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) “riciklimi i kartëmonedhave” është procesi (veprimi) i hedhjes përsëri në qarkullim të kartëmonedhave lek, të pranuar nga subjektet e kësaj rregulloreje gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre;

b) “makineri të trajtimit të kartëmonedhave” janë makineritë e përdorura nga klientët ose nga stafi i subjekteve, sipas përcaktimeve në nenet 11, 12 dhe 13 të kësaj rregulloreje;

c) “lloj i makinerisë së trajtimit të kartëmonedhës” janë makineri të trajtimit të kartëmonedhës që mund të dallohen nga njëra-tjetra, përmes sistemeve të tyre specifike të detektimit, programit (*software*) dhe komponentëve të tjerë për kryerjen e funksioneve kryesore. Këto funksione janë: a) autentifikimi i kartëmonedhave lek; b) detektimi dhe veçimi i kartëmonedhave lek të dyshuara si të falsifikuara; c) detektimi dhe veçimi i kartëmonedhave lek, të papërshtatshme nga ato të përshtatshme, në qoftë se është e zbatueshme; dhe d) gjurmimi i transaksioneve për kartëmonedhat lek të dyshuara si të falsifikuara dhe të kartëmonedhave lek që nuk janë autentifikuar qartë, në qoftë se është e zbatueshme;

d) “përpunim i kartëmonedhave” është kontrolli i sasisë, autenticitetit dhe përshtatshmërisë për qarkullim i kartëmonedhave, kryer nga subjektet e kësaj rregulloreje me anë të makinave të trajtimit të kartëmonedhave ose manualisht nga një anëtar i trajnuar i stafit;

e) “përpunim i automatizuar i kartëmonedhave” është përpunimi i kartëmonedhave me anë të makinerive të trajtimit të kartëmonedhave;

f) “përpunimi manual i kartëmonedhave” është vlerësimi vizual i kartëmonedhave nga anëtarë të trajnuar të stafit, duke përdorur pajisje autentifikimi, si dhe vlerësimi vizual i përshtatshmërisë së kartëmonedhave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë rregullore;

g) pajisje të autentifikimit të kartëmonedhave janë pajisjet për ekzaminimin e elementeve të sigurisë së kartëmonedhave, duke përfshirë zmadhuesit, llambat ultraviolet, kamerat me rreze infra të kuqe etj., të përdorura nga anëtarë të stafit gjatë përpunimit manual të kartëmonedhave për identifikimin e kartëmonedhave të dyshimta;

h) “autentifikimi i kartëmonedhave” është ekzaminimi i kartëmonedhave me qëllimin e veçimin e kartëmonedhave të dyshuara si të falsifikuara;

i) “kontrolli për përshtatshmëri i kartëmonedhave” është ekzaminimi i kartëmonedhave, me qëllim veçimin e kartëmonedhave të përshtatshme për qarkullim nga ato të papërshtatshme, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore;

j) “test i performancës së makinerive” është ekzaminimi, sipas procedurave të miratuara nga Banka e Shqipërisë, i sistemeve të brendshme të detektimit dhe aftësisë së makinerisë për zhvillimin e funksioneve kryesore të saj;

k) “anëtar stafi të trajnuar” janë punonjësit e subjekteve, të cilët kanë:

a) njohuri të elementeve të ndryshme publike të sigurisë së kartëmonedhave, të përcaktuara dhe të publikuara nga Banka e Shqipërisë dhe aftësinë për t’i kontrolluar ato; dhe

b) njohuri të kriterëve të përpunimit të përcaktuara në këtë rregullore dhe aftësinë për të kontrolluar kartëmonedhat lek në përputhje me to;

l) “nxjerrës i *cash-it*” është një makineri vetëshërbyese, e cila përmes përdorimit të një karte bankare ose mënyrave të tjera, i nxjerr kartëmonedhat lek publikut, duke debituar një llogari bankare, si p.sh. një ATM që nxjerr *cash*;

m) “klientë me status të veçantë” janë personat të cilët kanë fituar statusin e klientit të Bankës së Shqipërisë, nëpërmjet një ligji ose marrëveshje të veçantë dhe mund të kryejnë veprime në *cash* në Bankën e Shqipërisë.

KREU II

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR RICIKLIMIN E KARTËMONEDHAVE

Neni 5

Kontrolli për autenticitet dhe përshtatshmëri i kartëmonedhave lek

1. Subjektet e kësaj rregulloreje sigurojnë që kartëmonedhat lek që marrin gjatë veprimtarisë së tyre dhe që kanë për qëllim t’i hedhin përsëri në qarkullim, të kontrollohen për autenticitet dhe përshtatshmëri për qarkullim sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

2. Kontrolli i autenticitetit dhe përshtatshmërisë të kartëmonedhave lek kryhet:

a) nëpërmjet makinerive të trajtimit të kartëmonedhave të testuara paraprakisht nga Banka e Shqipërisë; ose

b) në mënyrë manuale nga një anëtar stafi i trajnuar për këtë qëllim.

3. Makineritë e përdorura nga stafi, kur përdoren me qëllimin e kontrollit të autenticitetit dhe përshtatshmërisë dhe makineritë e përdorura nga klienti mund të vihen në përdorim nga subjektet e kësaj rregulloreje, vetëm në qoftë se janë testuar me sukses nga Banka e Shqipërisë.

Neni 6

Detektimi i kartëmonedhave lek të dyshuara si të falsifikuara

1. Përpunimi i kartëmonedhave siguron që të gjitha kartëmonedhat e dyshimta të detektohen në kohë dhe të mos riciklohen te konsumatorët.

2. Subjektet e kësaj rregulloreje trajtojnë kartëmonedhat e veçuara si të dyshuara sipas kuadrit rregullator përkatës.

Neni 7

Detektimi i kartëmonedhave lek të papërshtatshme

1. Përpunimi i kartëmonedhave duhet të garantojë që kartëmonedhat e përshtatshme për qarkullim të veçohen nga të papërshtatshmet, në mënyrë që gjendja e kartëmonedhave në qarkullim të mbahet në nivele të kënaqshme.

2. Kontrolli i përshtatshmërisë kryhet në përputhje me standardet minimale të përcaktuara në këtë rregullore.

3. Kartëmonedhat lek të veçuara si të papërshtatshme për qarkullim gjatë procesit të përpunimit, dërgohen në Bankën e Shqipërisë.

Neni 8

Riciklimi i kartëmonedhave

1. Subjektet e kësaj rregulloreje mund të riciklojnë kartëmonedhat lek nëpërmjet makinerive të përdorura nga klientë ose nëpërmjet nxjerrësve të *cash-it*, vetëm në qoftë se ato janë kontrolluar



për autenticitet dhe përshtatshmëri nga një makineri e trajtimit të kartëmonedhave që është testuar me sukses nga Banka e Shqipërisë, dhe janë klasifikuar si autentike dhe të përshtatshme për qarkullim.

2. Kartëmonedhat lek, të cilat janë kontrolluar manualisht për autenticitet dhe përshtatshmëri, dhe janë klasifikuar si autentike dhe të përshtatshme nga një anëtar stafi i trajnuar, por jo nga një makineri e trajtimit të *cash*-it e testuar me sukses nga Banka e Shqipërisë, mund të riciklohen vetëm në sportel.

Neni 9 Përjashtime

1. Subjektet e kësaj rregulloreje mund të riciklojnë kartëmonedhat e përpunuara manualisht nga një anëtar i trajnuar i stafit, nëpërmjet makinerive të përdorura nga klientë ose nxjerrësve të *cash*-it, vetëm pasi kanë marrë miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë.

2. Banka e Shqipërisë jep miratimin për riciklimin nëpërmjet makinerive të përdorura nga klientë ose nxjerrësve të *cash*-it të kartëmonedhave të përpunuara manualisht vetëm në rastin e degëve të largëta, me një nivel transaksionesh të ulët.

3. Vëllimi i kartëmonedhave të kontrolluara manualisht për qëllime të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të kalojë 5% të vëllimit të përgjithshëm të kartëmonedhave të ricikluara nga banka ose dega e bankës së huaj nëpërmjet makinerive të përdorura nga klienti ose nxjerrësve të *cash*-it.

4. Subjektet e kësaj rregulloreje, për një periudhë të përkohshme, mund të riciklojnë kartëmonedhat e përpunuara manualisht nga një anëtar i trajnuar i stafit, nëpërmjet makinerive të përdorura nga klientë ose nxjerrësve të *cash*-it, në rastin e ndodhjes së një ngjarjeje të jashtëzakonshme (*force majeure*), e cila mund të ndikojë në uljen e ndjeshme të furnizimit me kartëmonedha.

5. Në rastin e ndodhjes së një ngjarjeje të jashtëzakonshme (*force majeure*), subjektet e kësaj rregulloreje njoftojnë menjëherë Bankën e Shqipërisë që kartëmonedhat dhe monedhat janë përpunuar manualisht. Ky njoftim duhet të shoqërohet dhe me një informacion të detajuar mbi natyrën e saktë të ngjarjes së jashtëzakonshme (*force majeure*) dhe kohëzgjatjen e pritshme të përpunimit manual.

KREU III MAKINAT E TRAJTIMIT TË KARTËMONEDHAVE

Neni 10 Kërkesa të përgjithshme teknike

1. Makinat e trajtimit të kartëmonedhave duhet të përpunojnë kartëmonedha lek, duke klasifikuar dhe veçuar fizikisht, ato sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje pa ndërhyrjen e operatorit të makinerisë.

2. Makineritë e trajtimit të kartëmonedhave duhet të kenë numrin e kërkuar të grumbulluesve/stivuesve (*stackers*) të dedikuar dhe/ose mjete të tjera për të siguruar klasifikimin dhe veçimin e saktë të kartëmonedhave lek që përpunohen.

3. Makineritë e trajtimit të kartëmonedhave duhet të jenë të adoptueshme për të siguruar detektimin me saktësi të kartëmonedhave false të reja dhe, nëse do të vlerësohet e nevojshme, të mundësojnë vendosjen e standardeve më lehtësuese apo më shtrënguese në klasifikimin e përshtatshmërisë.

Neni 11

Kategoritë e makinerive të trajtimit të kartëmonedhave

Makineritë e trajtimit të kartëmonedhave kategorizohen në makineri të përdorura nga klienti ose makineri të përdorura nga stafi.

Neni 12

Kategoritë e makinerive të përdorura nga klienti

Makineritë e përdorura nga klienti kategorizohen sipas përcaktimeve në tabelën 1.

Tabela 1

Makineri të përdorura nga klienti		
A. Makineri të përdorura nga klienti ku <i>cash</i>-i depozitohet me gjurmim të klientit		
1.	Makineri të depozitimit të <i>cash</i> -it (CIM-të)	Makineritë e depozitimit të <i>cash</i> -it (CIM) lejojnë klientët të depozitojnë kartëmonedha lek në llogaritë e tyre bankare, duke përdorur një kartë banke ose mjete të tjera, por nuk kanë ndonjë funksion të nxjerrjes së <i>cash</i> -it. Makineritë e depozitimit të <i>cash</i> -it (CIM) kontrollojnë kartëmonedhat për autenticitet dhe lejojnë për gjurmimin e mbajtësit të llogarisë; kontrollet e përshtatshmërisë janë opsionale.
2.	Makineri riqarkulluese të <i>cash</i> -it (CRM-të)	Makineritë riqarkulluese të <i>cash</i> -it (CRM) lejojnë klientët të depozitojnë dhe të tërheqin kartëmonedha lek nga llogaritë e tyre bankare, duke përdorur një kartë banke ose mjete të tjera. Makineritë riqarkulluese të <i>cash</i> -it (CRM-të) kontrollojnë kartëmonedhat lek për autenticitet dhe përshtatshmëri dhe lejojnë gjurmimin e mbajtësit të llogarisë. Për tërheqjen e kartëmonedhave, CRM-të mund të përdorin kartëmonedha lek autentike dhe të përshtatshme që janë depozituar nga klientët të tjerë në transaksionet e mëparshme.
3.	Makineri të kombinuara të depozitimit të <i>cash</i> -it (CCM-të)	Makineritë e kombinuara të depozitimit të <i>cash</i> -it (CCM-të) lejojnë klientët të depozitojnë dhe të tërheqin kartëmonedha lek nga llogaritë e tyre bankare, duke përdorur një kartë banke ose mjete të tjera. CCM-të kontrollojnë kartëmonedhat lek për autenticitet dhe lejojnë për gjurmimin e mbajtësit të llogarisë; kontrollet e përshtatshmërisë janë opsionale. Për tërheqje, CCM-të nuk përdorin kartëmonedha lek që kanë qenë depozituar nga klientët të tjerë në transaksionet e mëparshme, por vetëm kartëmonedha lek të ngarkuara veçmas në to.
Makineri të tjera të përdorura nga klienti		
4.	Makineri që nxjerrin <i>cash</i> (COM-të)	Makineritë që nxjerrin <i>cash</i> (COM) janë nxjerrëse të <i>cash</i> -it, të cilat kontrollojnë kartëmonedhat lek për autenticitet dhe përshtatshmëri, para se t'i nxjerrin ato për klientët. COM-të përdorin kartëmonedha lek të depozituara në to nga subjektet ose nga sisteme të tjera automatike (p.sh. makina shitëse).

Neni 13

Kategoritë e makinerive të përdorura nga stafi

1. Makineritë e përdorura nga stafi kategorizohen sipas përcaktimeve në tabelën 2.



Tabelë 2

Makineri të përdorura nga stafi		
1.	Makineri të përpunimit të kartëmonedhës (BPM)	Makineritë e përpunimit të kartëmonedhës (BPM-të) kontrollojnë kartëmonedhat lek për autenticitet dhe përshtatshmëri.
2.	Makineri të autentifikimit të kartëmonedhës (BAM)	Makineritë e autentifikimit të kartëmonedhës (BAM-të) kontrollojnë kartëmonedhat lek për autenticitet.
3.	Makineri ricikluese asistuese të sportelistit (TARM)	Makineritë ricikluese asistuese të sportelistit (TARM) janë makineri ricikluese të <i>cash</i> -it të përdorura nga trajtuesit e <i>cash</i> -it që kontrollojnë kartëmonedhat lek për autenticitet dhe përshtatshmëri. Për tërheqje, TARM mund të përdorin kartëmonedha lek autentike dhe të përshtatshme që kanë qenë depozituar nga klientë të tjerë në transaksione të mëparshme. Ato i ruajnë kartëmonedhat në mënyrë të sigurt dhe lejojnë trajtuesit e <i>cash</i> -it të kreditojnë apo debitojnë llogaritë bankare të klientëve.
4.	Makineri asistuese të sportelistit (TAM)	Makineritë asistuese të sportelistit (TAM) janë makineri të përdorura nga trajtues se <i>cash</i> -it që kontrollojnë kartëmonedhat lek për autenticitet. Ato i ruajnë kartëmonedhat në mënyrë të sigurt dhe lejojnë subjektet të kreditojnë ose debitojnë llogaritë bankare të klientëve.

2. Në rastin kur makineritë ricikluese asistuese të sportelistit (TARM) dhe makineritë asistuese të sportelistit (TAM) lejojnë përdorimin e tyre nga klientët për depozitim ose marrjen e kartëmonedhave, këto makineri duhet të konsiderohen makineri të përdorura nga klienti dhe duhet të klasifikojnë dhe trajtojnë kartëmonedhat lek në përputhje me nenin 14.

KREU IV
KLASIFIKIMI DHE TRAJTIMI I KARTËMONEDHAVE NGA MAKINAT E TRAJTIMIT
TË KARTËMONEDHAVE

Neni 14

Klasifikimi dhe trajtimi i kartëmonedhave nga makinat e përdorura nga klientët

1. Makineritë e përdorura nga klientët, klasifikojnë dhe veçojnë fizikisht kartëmonedhat lek në një nga kategoritë e përcaktuara në tabelën 3. Makineritë, të cilat nuk kontrollojnë kartëmonedhat lek për përshtatshmëri, nuk kanë nevojë të bëjnë dallim midis kategorive 4a dhe 4b.

Tabelë 3

Klasifikimi dhe trajtimi i kartëmonedhave lek nga makineri të përdorura nga klientët në të cilat <i>cash</i>-i depozitohet me gjurmim të klientit			
Kategoria	Vetitë	Trajtimi	
1	Objekte që nuk njihen si kartëmonedha lek	Nuk njihen si kartëmonedha lek, për shkak të një prej arsyeve të mëposhtme: - kartëmonedha jolek; - objekte të ngjashme me kartëmonedhë lek; - imazh ose format i gabuar; - përtsherje të mëdha të cepave ose pjesë që mungojnë; - gabim makinerie në ushqimin ose transportimin e kartëmonedhës.	Kthim nga makineria klientit.

2	Kartëmonedha lek të dyshuara si false	Imazhi dhe formati njihen, por një ose më shumë elemente autentifikimi të kontrolluara nga makineria, nuk detektohen ose janë qartësisht jashtë tolerancës.	Tërheqje nga qarkullimi. Të dorëzohen për autentifikim në Bankën e Shqipërisë, së bashku me informacion në lidhje mbajtësin e llogarisë jo më vonë se 20 ditë pune nga data e depozitimit në makineri. Të mos i kreditohet mbajtësit të llogarisë.
3	Kartëmonedha lek që nuk autentifikohen qartësisht	Imazhi dhe formati njihen, por jo të gjitha elementet e autentifikimit të kontrolluara nga makineria janë njohur për shkak të cilësisë dhe/ose deviacioneve në tolerancë. Në shumicën e rasteve kartëmonedha të papranueshme.	Tërheqje nga qarkullimi. Kartëmonedhat lek përpunohen veçantë dhe dorëzohen për autentifikim në Bankën e Shqipërisë, së bashku me informacion në lidhje mbajtësin e llogarisë jo më vonë se 20 ditë pune pas depozitimit në makineri. Mund t'i kreditohet mbajtësit të llogarisë.
4a	Kartëmonedha lek që janë identifikuar si autentike dhe të përshtatshme	Të gjitha kontrollet e autenticitetit dhe përshtatshmërisë të kryera nga makineria japin rezultate pozitive.	Mund të përdoret për riqarkullim. I kreditohet mbajtësit të llogarisë.
4b	Kartëmonedha lek që identifikohen si autentike dhe të papërshtatshme	Të gjitha kontrollet e autenticitetit të kryera nga makineria japin rezultate pozitive. Të paktën një kriter i përshtatshmërisë jep rezultat negativ.	Nuk mund të përdoren për riqarkullim dhe kthehen në Bankën e Shqipërisë. I kreditohen mbajtësit të llogarisë.

2. Në rastin kur makineria lejon anulimin e një transaksioni depozitimi, kartëmonedhat lek të klasifikuara në kategoritë 2 dhe 3 nuk i kthehen klientit. Mbajtja e të tilla kartëmonedhave lek, kur një transaksion anulohet, mund të bëhet duke i ruajtur ato në një hapësirë të përkohshme ruajtjeje, brenda makinerisë.

Neni 15

Klasifikimi dhe trajtimi i kartëmonedhave nga makinat e përdorura nga stafi

1. Makineritë e përdorura nga stafi klasifikojnë dhe veçojnë fizikisht kartëmonedhat lek në një nga kategoritë e mëposhtme, të përcaktuara në tabelën 4. Makineritë, të cilat nuk kontrollojnë kartëmonedhat lek për përshtatshmëri nuk kanë nevojë të bëjnë dallim midis kategorive B1 dhe B2.

Tabelë 4

Klasifikimi dhe trajtimi i kartëmonedhave nga makinat e përdorura nga stafi		
Kategoria	Vetitë	Trajtimi
A	i) Nuk njihen si kartëmonedha lek për shkak të një prej arsyeve të mëposhtme: - kartëmonedha jolek; - objekte të ngjashme me kartëmonedha lek; - imazh ose format i gabuar; - cepa me palosje të madhe ose pjesë që mungojnë; - gabim i makinerisë gjatë	Kthim nga makineria operatorit për vlerësim dhe trajtim të mëtejshëm i) objektet nuk njihen si kartëmonedha lek: pas vlerësimit vizual nga një anëtar i stafit këto veçohen nga kartëmonedhat lek të dyshuara si false dhe kartëmonedhat lek që nuk janë autentifikuar qartësisht; ii) kartëmonedha lek të dyshuara si



		furnizimit ose transportimit të kartëmonedhës; ii) identifikohen si kartëmonedha lek të dyshuara si false, për shkak se imazhi apo formati u njohën, por një ose më shumë elemente autentifikimi të kontrolluara nga makineria nuk detektohen ose janë qartësisht jashtë tolerancës; iii) kartëmonedha lek që nuk janë autentifikuar qartësisht për shkak se imazhi dhe formati janë njohur, por jo të gjitha elementet e sigurisë të kontrolluara nga makineria janë njohur për shkak të cilësisë dhe/ose devijimeve në tolerancë. Në shumicën e rasteve kartëmonedha lek të papërshtatshme.	false; dhe iii) kartëmonedha lek që nuk janë autentifikuar qartësisht: këto procesohen veçantë dhe dorëzohen menjëherë për autentifikim përfundimtar te Banka e Shqipërisë, jo më vonë se 20 ditë pune pas depozitimit në makineri.
B1	Kartëmonedha lek që janë identifikuar si autentike dhe të përshtatshme.	Të gjitha kontrollet e autenticitetit dhe përshtatshmërisë të kryera nga makineria japin rezultate pozitive.	Mund të përdoren për riqarkullim. I kreditohen mbajtësit të llogarisë
B2	Kartëmonedha lek që janë identifikuar si origjinale dhe të papranueshme.	Të gjitha kontrollet mbi autenticitetin të kryera nga makineria japin rezultate pozitive. Të paktën një kriter përshtatshmërie jep rezultat negativ.	Nuk mund të përdoren për riqarkullim dhe të kthehen në Bankën e Shqipërisë. I kreditohen mbajtësit e llogarisë.

Neni 16

Rregulla specifike të klasifikimit për disa makineri të përdorura nga stafi

1. Makineritë e përpunimit të kartëmonedhave (BMP-të) klasifikojnë dhe veçojnë fizikisht kartëmonedhat lek në kategoritë A, B1 dhe B2. Për realizimin e këtij procesi makineritë e përpunimit të kartëmonedhave janë të pajisura me të paktën tre stivues të dedikuara, me qëllim evitimin e ndërhyrjes së operatorit të makinerisë.

2. Makineritë e përpunimit të kartëmonedhave (BMP-të) të pajisura me vetëm dy stivues të dedikuara në dalje, mund të klasifikojnë dhe veçojnë kartëmonedhat lek, në qoftë se plotësohen kërkesat e mëposhtme:

a) kontrollet për autenticitetin dhe përshtatshmërinë kryhen në të njëjtin kalim. Në këtë kalim, çdo kartëmonedhë lek e kategorisë B1 duhet të veçohet në një stivues të palëvizshëm në dalje, ndërsa kartëmonedhat lek të dy kategorive A dhe B2 duhet të veçohen në stivuesin tjetër të palëvizshëm në dalje, që nuk ka kontakt fizik me kartëmonedhat lek të kategorisë B1;

b) kartëmonedhat e veçuara në stivuesin e dytë do të kontrollohen dhe një herë në një kalim të dytë. Në këtë kalim të dytë, kartëmonedhat lek të dyshuara si false duhet të ndahen nga kartëmonedhat lek të kategorisë B2, duke i veçuar në stivosës dalës të dedikuara.

3. Makineritë e autentifikimit të kartëmonedhave (BAM) klasifikojnë dhe veçojnë fizikisht kartëmonedhat lek në kategoritë A dhe B. Për realizimin e këtij veprimi makineritë e autentifikimit të kartëmonedhave janë të pajisura me të paktën dy stivues dalës të dedikuara, me qëllim shmangien e ndërhyrjes së operatorit të makinerisë.

4. Makineritë e autentifikimit të kartëmonedhave (BAM), të pajisura me vetëm një stivues dalës të dedikuara, mund të klasifikojnë dhe veçojnë kartëmonedhat lek, në qoftë se plotësohen kërkesat e mëposhtme:

a) çdo herë që veçohet një kartëmonedhe lek e kategorisë A, makineria duhet të ndalojë përpunimin menjëherë dhe të mbajë kartëmonedhën lek të kategorisë A në një pozicion që shmang kontaktin fizik me kartëmonedha lek të autentifikuara;

b) rezultati i këtij kontrolli autenticiteti duhet të tregohet në një ekran për çdo kartëmonedhë lek të kategorisë A;

c) makineria duhet të kontrollojë për praninë e një kartëmonedhe lek të kategorisë A kur ndërpret përpunimin dhe përpunimi mund të rifillojë pas heqjes fizike të kartëmonedhës lek të kategorisë A nga ana e operatorit;

d) për çdo ndalim të përpunimit jo më shumë se një kartëmonedhë lek e kategorisë A mund të jetë e aksesueshme nga operatori.

KREU IV STANDARDET MINIMALE PËR KONTROLLIN E PËRSHTATSHMËRISË SË KARTËMONEDHAVE

Neni 17

Standardet minimale për kontrollin e automatizuar për përshtatshmërinë e kartëmonedhave

1. Kartëmonedhat lek, të kontrolluara për përshtatshmëri nga makinat e trajtimit të kartëmonedhave, do të konsiderohen si të papërshtatshme për qarkullim në rastin kur nuk plotësojnë standardin minimal të përcaktuar për të paktën një nga kërkesat e radhitura në pikën 3 të këtij neni.

2. Niveli i pranueshëm i tolerancës për kontrollet e përshtatshmërisë nga makineritë e trajtimit të kartëmonedhave është 5%. Makineritë e trajtimit të kartëmonedhave nuk duhet të klasifikojnë si kartëmonedha të përshtatshme për qarkullim më shumë se 5% të kartëmonedhave lek, që nuk përmbushin kriteret e përshtatshmërisë.

3. Kontrolli për përshtatshmërinë e kartëmonedhave me makineri të trajtimit të kartëmonedhave bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në tabelën 5.

Tabelë 5

Lista e kriterëve për kontrollin e automatizuar të përshtatshmërisë së kartëmonedhave		
	Kriteri	Përkufizim
1.	Ndotje	Shpërndarje e përgjithshme e papastërtisë gjatë gjithë kartëmonedhës lek
2.	Njollë	Përqendrim i lokalizuar papastërtie
3.	Vizatime	Imazh i shtuar ose shkronja të shkruara ose shënime të çdo lloji mbi një kartëmonedhë lek
4.	Kartëmonedhë e çngjyrosur	Mungese boje në një pjesë ose në të gjithë kartëmonedhën lek, p.sh. një kartëmonedhe lek e larë
5.	Grisje	Vetëkuptohet
6.	Vrimë	Vetëkuptohet
7.	Gjymtim	Kartëmonedhë lek me pjesë që mungojnë, përgjatë të paktën një anë
8.	Riparim	Pjesë të një ose më shumë kartëmonedhave lek, të bashkuara me ngjitës ose mjete të tjera
9.	Zhubra	Palosje të shumta të çfarëdoshme
10.	Butësi	Degjenerim struktural që rezulton në mungesë të theksuar të fortësisë
11.	Palosje	Vetëkuptohet
12.	Palosje e cepit	Vetëkuptohet



4. Detektorët e brendshëm në makineritë e trajtimit të kartëmonedhave duhet të adoptohen për veçimin e kartëmonedhave të papërshtatshme për qarkullim, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni dhe specifikimeve të përcaktuara në aneksin 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 18

Standardet minimale për kontrollin manual për përshtatshmërinë e kartëmonedhave

1. Kartëmonedhat lek, të kontrolluara manualisht për përshtatshmëri nga anëtarë të trajnuar të stafit, do të konsiderohen si të papërshtatshme për qarkullim, në rastin kur dukshëm plotësojnë të paktën një nga kriteret e përcaktuara në tabelën 6.

Tabelë 6

Listë e kriterëve për kontrollin manual të përshtatshmërisë së kartëmonedhave		
Veçoria		Përshkrimi
1.	Ndotje	Shpërndarje papastërtie përgjatë kartëmonedhës lek, e dukshme vizualisht
2.	Njollë	Përqendrim i lokalizuar i papastërtisë, i dukshëm vizualisht
3.	Vizatime	Imazh i shtuar, germëzime të shkruara ose shënime të çdo lloji, të dukshme vizualisht mbi një kartëmonedhë lek
4.	Kartëmonedhë e çngjyrosur	Mungesë ngjyre në pjesë ose tërësi të një kartëmonedhe lek e dukshme vizualisht, p.sh. një kartëmonedhë e larë
5.	Grisje	Kartëmonedhë lek me të paktën një grisje në anë
6.	Vrimë	Kartëmonedhe lek me të paktën një vrimë të dukshme vizualisht
7.	Gjymtim	Kartëmonedhë lek me një ose disa pjesë që mungojnë përgjatë të paktën një ane, p.sh. një cep që mungon
8.	Riparim	Pjesë të një ose më shumë kartëmonedhave lek të bashkuara me shirit, ngjitës ose mënyra të tjera
9.	Zhubra	Kartëmonedhë lek me disa palosje të çfarëdoshme përgjatë saj, që ndikojnë shumë në pamjen e saj vizuale
10.	Butësi	Kartëmonedhë lek me degjenerim struktural që rezulton në mungesë të theksuar të fortësisë
11.	Cep i palosur	Kartëmonedhë lek me të paktën një cep qartësisht të palosur

2. Pavarësisht përcaktimeve në pikën 1 të këtij neni, në rastin kur është e mundur, kartëmonedhat lek të palosura ose me cepa të palosur mund të rregullohen përmes shpalosjes manuale.

3. Kontrollët manuale të përshtatshmërisë kryhen nëpërmjet një inspektimi vizual të kartëmonedhave lek individuale dhe nuk kërkojnë përdorimin e ndonjë mjeti.

KREU V

TESTET PËR KONTROLLIN E PERFORMANCËS SË MAKINERIVE

Neni 19

Teste performance të makinerive

1. Subjektet e kësaj rregulloreje për përpunimin e kartëmonedhave mund të përdorin vetëm makineri, performanca e të cilave është testuar me sukses nga Banka e Shqipërisë.

2. Testet e performancës së makinerive duhet të përfshijnë, në varësi të llojit të makinerisë, një ekzaminim të performancës së makinerisë në kontrollin e kartëmonedhave për sasi, autenticitet dhe përshtatshmëri.

3. Testet e performancës së makinerive zhvillohen bazuar në procedurën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë dhe kanë për qëllim ekzaminimin e sistemeve të brendshme të detektimit dhe aftësinë e makinerisë për zhvillimin e funksioneve kryesore si më poshtë:

- a) autentifikimi i kartëmonedhave lek;
- b) detektimi dhe veçimi i kartëmonedhave lek të dyshuara si të falsifikuara;
- c) detektimi dhe veçimi i kartëmonedhave lek të papërshtatshme nga ato të përshtatshme, në qoftë se është e zbatueshme; dhe
- d) gjurmimi i objekteve të identifikuar si kartëmonedha lek të dyshuara si false dhe të kartëmonedhave lek që nuk janë autentifikuar qartë, në qoftë se është i zbatueshëm.

4. Banka e Shqipërisë për testimin e performancës së çdo tipi makinerie përdor kartëmonedha false të gjetura në qarkullim dhe kartëmonedha autentike të përshtatshme dhe të papërshtatshme.

5. Identifikimi i kartëmonedhave duhet të testohet vetëm mbi kartëmonedhat e falsifikuara të gjetura në qarkullim që janë në dispozicion të Bankës së Shqipërisë, të cilat janë përdorur gjatë testimit të makinerive.

6. Banka e Shqipërisë nuk mban përgjegjësi në qoftë se makineria dështon t'u përmbahet kërkesave të kësaj rregulloreje, pavarësisht faktit që lloji i makinerisë në fjalë është testuar me sukses.

7. Banka e Shqipërisë kryen testin e performancës për një lloj makinerie bazuar në aplikimin e bërë nga prodhuesi i makinerisë ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij.

8. Prodhuesi i makinerisë ose personi i autorizuar prej tij, i dorëzon aplikimin pranë Bankës së Shqipërisë, së bashku me të gjithë informacionin përkatës, me rëndësi mbi funksionimin e makinerisë. Banka e Shqipërisë do ta trajtojë këtë informacion si konfidencial.

9. Banka e Shqipërisë, në përfundim të testit të performancës, do të lëshojë një raport mbi testin e performancës së një makinerie. Raporti mbi testin e suksesshëm të makinerisë do të lëshohet për një periudhë të kufizuar kohe. Banka e Shqipërisë do të përcaktojë në çdo raport afatin kohor brenda të cilit performanca e një makinerie duhet të riestohet.

10. Banka e Shqipërisë do të publikojë në faqen e saj të internetit një listë të llojeve të makinerive, të cilat kanë kaluar me sukses testet e performancës.

11. Për çdo përmirësim ose përditësim të *hardware/software*-it në makineritë që kanë kaluar me sukses testet e performancës, prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar duhet të dërgojë një aplikim për riestimin e performancës së këtyre makinerive.

Neni 20

Përdorimi i makinerive nga subjektet e kësaj rregulloreje

1. Subjektet e kësaj rregulloreje, për trajtimin e kartëmonedhave lek, mund të përdorin llojet e makinerive që përfshihen në listën e publikuar në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

2. Subjektet e kësaj rregulloreje duhet të njoftojnë Bankën e Shqipërisë mbi instalimin e një makinerie të trajtimit të kartëmonedhave, përpara se makineria të vihet në punë.

3. Subjektet e kësaj rregulloreje duhet të marrin një deklaratë nga prodhuesi i makinerisë ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, që garanton se karakteristikat e makinerisë së instaluar korrespondojnë me ato të makinerisë, të përfshirë në listën e publikuar në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë dhe që makineria e instaluar përpunon kartëmonedha në të njëjtën mënyrë si makineria e të njëjtit lloj të testuar nga Banka e Shqipërisë. Subjektet duhet të dorëzojnë në Bankën e Shqipërisë deklarinë së bashku me njoftimin e instalimit të makinerisë.



Neni 21

Monitorimi i makinerive përpara vënies së tyre në punë

Me marrjen e njoftimit për instalimin e makinerisë, Banka e Shqipërisë kryen një kontroll të hartimit dhe zbatimit të procedurave për përpunimin e kartëmonedhave dhe kryen testet e performancës së makinerive të instaluara, në mënyrë që të përcaktojë nëse këto makineri kontrollojnë kartëmonedhat dhe monedhat në mënyrë të besueshme mbi autenticitetin dhe përshtatshmërinë për qarkullim dhe lejojnë ndjekjen/regjistrimin e transaksioneve.

KREU VI

RAPORTIMI DHE MBIKËQYRJA (INSPEKTIMI)

Neni 22

Monitorimi

1. Departamenti i Emisionit pranë Bankës së Shqipërisë realizon verifikimin e zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje nëpërmjet:

a) kryerjes së inspektimeve në vend, përfshirë këtu dhe inspektimet e panjoftuara, në vendndodhjet e subjekteve, për të monitoruar makineritë e tyre të trajtimit të kartëmonedhave, në veçanti aftësinë e makinerive për të kontrolluar për autenticitet dhe përshtatshmëri dhe për gjurmimin e kartëmonedhave të dyshuara si false dhe kartëmonedhave që nuk autentifikohen qartë, te mbajtësi i llogarisë; dhe

b) verifikimit të procedurave që rregullojnë operimin dhe kontrollin e makinerive të trajtimit të *cash*-it, trajtimin e kartëmonedhave lek të kontrolluara dhe procedurat që rregullojnë çdo kontroll manual të autenticitetit dhe përshtatshmërisë.

2. Banka e Shqipërisë, për verifikimin e zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje gjatë procesit të inspektimit në mjediset e subjekteve, mund të marrë kampione të kartëmonedhave të përpunuara për t'i kontrolluar ato në ambientet e saj.

3. Në rast konstatimi të moszbatimit të dispozitave të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë përcakton marrjen e masave korrigjuese nga ana e subjekteve brenda një afati kohor të caktuar.

Neni 23

Raportimi në Bankën e Shqipërisë

Subjektet e kësaj rregulloreje raportojnë në Bankën e Shqipërisë informacionin sipas kërkesave të përcaktuara në aneksin II.

Neni 24

Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat ndëshkimore të parashikuara në ligjin për bankat dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 25
Dispozitë kalimtare

1. Subjektet e kësaj rregulloreje janë të detyruara të plotësojnë të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, jo më vonë se 3 muaj pas hyrjes në fuqi të saj.

2. Pavarësisht pikës 1 të këtij neni, makineritë e trajtimit të kartëmonedhave të instaluar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet të përshtaten për kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, jo më vonë se 9 muaj nga hyrja në fuqi e saj.

3. Subjektet, jo më vonë se 1 muaj pas hyrjes në fuqi të rregullores duhet të paraqesin në Bankën e Shqipërisë një plan për përmbushjen e kërkesave të rregullores gjatë periudhës kalimtare.

4. Plani për përmbushjen e kërkesave të kësaj rregulloreje duhet të përmbajë të paktën:

a) një listë të njësive operacionale;

b) një listë të makinave të përdorura nga klientë dhe nxjerrësve të *cash*-it që përdoren për shpërndarjen e kartëmonedhave klientëve;

c) volumin e planifikuar të kartëmonedhave që do të shpërndahen nëpërmjet makinave të përdorura nga klientë dhe nxjerrësve të *cash*-it për një periudhë njëvjeçare;

d) vëllimin e planifikuar të përpunimit të kartëmonedhave që do të riciklohen për klientët për një periudhë njëvjeçare, të ndarë sipas njësive operacionale, makinave të përdorura nga klientë dhe nxjerrësve të *cash*-it;

e) organizimin e përpunimit të vëllimit të planifikuar të kartëmonedhave dhe miratimin e procedurave të përpunimit, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;

f) numrin dhe llojet e makinerive të trajtimit të kartëmonedhave të instaluar deri në momentin e hyrjes në fuqi të rregullores dhe shpërndarjen, sipas vendndodhjes të makinerive të instaluar;

g) planin dhe dinamikën e përshtatjes së makinerive sipas kërkesave të kësaj rregulloreje gjatë periudhës së tranzicionit;

h) kapacitetin total të planifikuar të të gjitha makinerive të kartëmonedhave pas periudhës së tranzicionit (kapaciteti i makinerive të instaluar i rritur me kapacitetin e makinerive të planifikuara për t'u instaluar deri në fund të periudhës së tranzicionit), i ndarë sipas çdo lloji makinerie.

5. Banka e Shqipërisë mund të kërkojë specifikim të mëtejshëm të informacionit të dorëzuar ose informacion tjetër shtesë, në rastin kur ajo konstaton se plani i dorëzuar për zbatimin e rregullores për periudhën e tranzicionit, nuk përfshin të gjithë informacionin e nevojshëm ose informacioni nuk është hartuar në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

Neni 26

Të tjera

1. Banka e Shqipërisë trajton informacionin e marrë sipas kësaj rregulloreje si konfidencial.

2. Banka e Shqipërisë do të publikojë në faqen e saj zyrtare të internetit, procedurat teknike për testet e performancës së makinerive dhe formularin e aplikimit.

Neni 27

Dispozitë e fundit

Anekset bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.



ANEKSI 1
STANDARDET MINIMALE PËR KRITERET E PËRPUNIMIT AUTOMATIK
TË KARTËMONEDHAVE

1. Ndotje

Papastërtia rrit dendësinë optike të kartëmonedhave lek. Tabela e mëposhtme specifikon rritjen maksimale të dendësisë të monstrave kufi krahasuar me kartëmonedha lekë të rinj, që kartëmonedhat lek mund të shfaqin për t'u klasifikuar si të pranueshme:

Tabelë 1

Nivelet e dendësisë optike

Prerja	Rritja maksimale e dendësisë së mostrës kufi krahasuar me kartëmonedhë lek të rinj
Lekë 200	0.06
Lekë 500	0.06
Lekë 1000	0.08
Lekë 2000	0.07
Lekë 5000	0.04

Kartëmonedhat lek që nuk i përmbushin këto kritere janë të papranueshme.

Banka e Shqipërisë mban kartëmonedha lek referencë që tregojnë një nivel papastërtie të derivuar nga këto kritere.

2. Njollë

Kartëmonedha lek me përqendrim të lokalizuar papastërtie të paktën 9 mm me 9 mm në pjesën e paprintuar, ose të paktën 15 mm me 15 mm në pjesën e printuar është e papranueshme.

3. Vizatime

Kartëmonedha me përqendrim të lokalizuar shkrimi ose vizatimi të paktën 9 mm me 9 mm, në pjesën e paprintuar ose të paktën 15 mm me 15 mm, në pjesën e printuar është e papranueshme.

4. Kartëmonedhë e çngjyrosur

Çngjyrimi i kartëmonedhave lek mund të ndodhë, p.sh. kur ato janë larë ose nën veprimin e agjentëve të fortë kimikë. Këto lloje të kartëmonedhave lek të papranueshme mund të detektohen me detektorë imazhi ose detektorë ultravioletë.

5. Grisje

Kartëmonedhat lek me grisje, të cilat janë të hapura dhe jo të mbuluara pjesërisht apo plotësisht nga rripat e transportit të makinerisë janë të papranueshme në qoftë se madhësia e grisjes është më e madhe se sa tregohet më poshtë.

Tabelë 2

Grisje

Drejtimi	Gjerësia	Gjatësia
Vertikal	4 mm	8 mm
Horizontal	4 mm	15 mm
Diagonal	4 mm	18 mm(*)

(*) Kjo matet duke hequr një vijë të drejtë nga kulmi i grisjes deri tek ana e kartëmonedhës ku fillon grisja (projeksion koordinatë), në vend që të matet gjatësia e vetë grisjes.

6. Vrimë

Kartëmonedhat lek me vrima që nuk janë pjesërisht apo plotësisht të mbuluara nga rripat e transportimit të makinerisë, janë të papranueshme në qoftë se sipërfaqja e vrimës është më e madhe se 10 mm².

7. Gjymtim

Kartëmonedha lek me gjatësi të reduktuar me 6 mm apo më shumë, ose gjerësi të reduktuar me 5 mm apo më shumë janë të papranueshme. Të gjitha matjet lidhen me diferencat prej gjatësive dhe gjerësive nominale të kartëmonedhave lek.

8. Riparim

Një kartëmonedhë lek e riparuar krijohet duke bashkuar pjesë të kartëmonedhës (kartëmonedhave) së bashku, p.sh. duke përdorur shirit ose ngjitës. Një kartëmonedhë lek me shirit që mbulon një sipërfaqe më të madhe se 10 mm me 40 mm dhe e cila është më shumë se 50 µm e trashë, është e papranueshme.

9. Zhubra

Kartëmonedhat lek të zhubrosura normalisht mund të identifikohen në qoftë se niveli i tyre i reflektancës ose fortësisë është reduktuar.

10. Butësia

Kartëmonedhat lek me fortësi strukturale të reduktuar ndjeshëm veçohen si të papranueshme. Duke qenë se butësia normalisht ka lidhje me ndotjen, kartëmonedhat lek të buta përgjithësisht detektohen dhe përmes detektorëve të papastërtisë.

11. Palosje

Kartëmonedhat lek të palosura, për shkak të gjatësisë ose gjerësisë së reduktuar, mund të detektohen nga sensorë që kontrollojnë për madhësinë e kartëmonedhave lek. Gjithashtu, ato mund të detektohen nga sensorë trashësie. Megjithatë, për shkak të kufizimeve teknike, vetëm palosje që plotësojnë kriteret e përcaktuara për gjymtimet, d.m.th. palosje që çojnë në një reduktim në gjatësi më shumë se 6 mm ose një reduktim në gjerësi më shumë se 5 mm, mund të identifikohen dhe janë të papranueshme.

12. Cep i palosur

Një kartëmonedhë lek me një cep të palosur me një sipërfaqe prej më shumë se 130 mm² dhe një gjatësi më të madhe se 10 mm në anën më të shkurtër është e papranueshme.

ANEKSI 2

MBLEDHJA E TË DHËNAVE NGA SUBJEKTET

1. Objektiva

Objektivat e mbledhjes së të dhënave janë për t'i bërë të mundur Bankës së Shqipërisë të monitorojë aktivitetet më kryesore në trajtimin e *cash*-it dhe për të mbikëqyrur zhvillimet në ciklin e *cash*-it.

2. Parime të përgjithshme

2.1 Të dhënat mbi makineritë e trajtimit të *cash*-it raportohen vetëm kur makineritë përdoren për riciklimin e kartëmonedhave lek.

2.2 Trajtuesit e *cash*-it i mundësojnë rregullisht Bankës së Shqipërisë informacionet e mëposhtme:

- informacion mbi ambientet ku trajtohet *cash*-i, si p.sh. ambiente degësh; dhe
- informacion mbi makineritë e trajtimit të *cash*-it dhe nxjerrësit e *cash*-it.

2.3 Veç kësaj, trajtuesit e *cash*-it që riqarkullojnë kartëmonedha lek përmes makinerive të trajtimit të kartëmonedhave dhe nxjerrësve të *cash*-it, në mënyrë të rregullt i raportojnë Bankës së Shqipërisë informacionet e mëposhtme:



- informacion mbi vëllimin e veprimeve të *cash*-it (numri i kartëmonedhave lek të përpunuara) me makineritë e trajtimit të kartëmonedhave dhe nxjerrësit e *cash*-it,

- informacion mbi degët e largëta të subjekteve me një nivel të ulët të veprimeve *cash*, ku kontrollet e përshtatshmërisë kryen manualisht.

3. Lloji i të dhënave dhe kërkesat e raportimit

3.1 Në varësi të natyrës së tyre, të dhënat e mbledhura ndahen në të dhëna kryesore dhe të dhëna operacionale.

Të dhëna kryesore

3.2 Të dhënat kryesore mbulojnë informacionin mbi: a) trajtuesit e *cash*-it dhe makineritë e tyre të trajtimit të kartëmonedhave dhe nxjerrësit e *cash*-it në përdorim; dhe b) degët e largëta të subjekteve.

3.3 Të dhënat kryesore raportohen në Bankën e Shqipërisë me frekuencë 3-mujore nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje. Të dhënat raportohen sipas specifikimeve në modelin e përcaktuar në aneksin 2A.

Të dhëna operacionale

3.4 Të dhënat që rezultojnë nga përpunimi dhe riqarkullimi i kartëmonedhave lek nga trajtuesit e *cash*-it klasifikohen si të dhëna operacionale. Të dhënat raportohen në Bankën e Shqipërisë me frekuencë 3-mujore. Të dhënat raportohen në Bankën e Shqipërisë jo më vonë se 1 muaj pas periudhës së raportimit. Të dhënat raportohen sipas modelit të përcaktuar në aneksin 2B.

3.5 Të dhënat raportohen nga trajtues *cash*-i në sasi (copë), të agreguara në nivel kombëtar dhe të ndara sipas prerjeve të kartëmonedhave lek. Për degët e largëta të subjekteve, të dhënat operacionale raportohen veças.

4. Konfidencialiteti dhe publikimi i të dhënave

4.1 Të dhënat kryesore dhe të dhënat operacionale trajtohen si konfidenciale.

4.2 Banka e Shqipërisë mund të publikojë raporte ose statistika, duke përdorur të dhëna të grumbulluara sipas kësaj rregulloreje. Publikimi do të përmbajë vetëm të dhëna të agreguara, në mënyrë të tillë që asnjë e dhënë nuk mund t'i atribuohet një subjekti të vetëm raportues.

ANEKSI 2A MODEL RAPORTIMI

Të dhëna kryesore

1. Informacion i trajtuesit të *cash*-it

Emri i trajtuesit të *cash*-it:

Adresa e zyrave qendrore:

Qyteti:

Rruga:

Personat e kontaktit:

Emrat:

Numrat e telefonit:

Numrat e fax-it:

Adresat e e-mail-it:

2. Makineri të operuara nga klienti

Lloji	Prodhuesi (*)	Emri i makinerisë (*)	Identifikimi (*) (sistemi i detektimit/versionet e programit)	Numri total në punë
CIM				
CRM				
CCM				
COM				
TARM(**)				
TAM(*)				

(*) Këto të dhëna plotësohen duke ndjekur të dhënat që korrespondojnë në faqen e internetit të BSH-së.
(**) në rastin kur funksionojnë si makineri të përdorura nga klienti.

3. Makineri të përdorura nga stafi

Lloji	Prodhuesi (*)	Emri i makinerisë (*)	Identifikimi (*) (sistemi i detektimit/versionet e programit)	Numri total në punë
BPM				
BAM				
TARM(**)				
TAM(*)				

(*) Këto të dhëna plotësohen duke ndjekur të dhënat që korrespondojnë në faqen e internetit të BSH-së
(**) në rastin kur funksionojnë ekskluzivisht si makineri të përdorura nga stafi.

4. Nxjerrës të *cash*-it

Lloji	Numri total në punë
ATM-ja	
Të tjera	

ANEKSI 2B MODEL RAPORTI Të dhëna operationale

1. Informacion mbi trajtuesin e *cash*-it

Emri i trajtuesit të <i>cash</i> -it	
Periudha e raportimit	

2. Të dhëna

	Numri total i kartëmonedhave lek të përpunuara ⁽¹⁾	Nga të cilat të veçuara si të papërshtatshme	Nga të cilat të riqarkulluara ⁽²⁾
Lekë 200			
Lekë 500			
Lekë 1000			
Lekë 2000			
Lekë 5000			

⁽¹⁾ Përfshin të dyja, makineri të përdorura nga klientë dhe stafi.
⁽²⁾ Përfshihen kartëmonedhat lek që i janë kthyer Bankës së Shqipërisë dhe kartëmonedhat lek të ricikluarara në sportel, që nuk janë përpunuar në makineri të përdorura nga stafi.



	Numri i kartëmonedhave lek të shpërndara përmes makinerive të përdorura nga klientë dhe përmes nxjerrësve të <i>cash-it</i>
Lekë 200	
Lekë 500	
Lekë 1000	
Lekë 2000	
Lekë 5000	

ANEKSI 2C
DEGË TË LARGËTA TË SUBJEKTEVE

Ky informacion raportohet vetëm nga subjektet të cilët kanë degë të largëta siç përcaktohet në nenin 9 të kësaj rregulloreje.

1. Informacion mbi subjektin

Emri i subjektit	
Periudha e raportimit	

2. Të dhëna

Emri i degës së largët	Adresa	Numri i kartëmonedhave lek të shpërndara përmes makinerive të përdorura nga klientë dhe nxjerrësve të <i>cash-it</i>
		Lekë 200
		Lekë 500
		Lekë 1000
		Lekë 2000
		Lekë 5000

VENDIM
Nr. 17, datë 13.2.2013

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KËMBIMIT TË DISA KARTËMONEDHAVE
PA KURS LIGJOR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1 pika 4 shkronja “b”, të nenit 40 pika 5, të nenit 43 shkronjat “c” dhe “d” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të kreut II të udhëzimit “Për hedhjen në qarkullim të prerjeve të reja të kartëmonedhave dhe monedhave kombëtare e për tërheqjen nga qarkullimi i parasë”, miratuar me vendimin nr. 27, datë 30.3.1998 të Këshillit Mbikëqyrës; të nenit 9 shkronja “f” të rregullores “Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Emisionit”, miratuar me vendimin nr. 4, datë 16.1.2012 të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar; dhe me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Kartëmonedhat e mëposhtme pa kurs ligjor do të mblidhen për këmbim, kundrejt pagesës së vlerës fillestare të emetimit, me kartëmonedha dhe monedha të tjera në qarkullim, deri në datën 31.12.2023.

- a) 100 lekë, emetim i viteve 1993, 1994, 1996, imazhi i Luftëtarit Kombëtar;
- b) 100 lekë, emetim i vitit 1996, imazhi i Fan S. Nolit;
- c) 200 lekë, emetim i viteve 1992, 1994, 1996, imazhi i Ismail Qemalit;
- d) 500 lekë, emetim i vitit 1991,1992,1993,1996,1997, imazhi lule dielli;
- e) 500 lekë, emetim i vitit 1992, 1994, 1996, imazhi i Naim Frashërit; dhe
- f) 1000 lekë, emetim i vitit 1992,1994,1995,1996, imazhi i Skënderbeut.

2. Ngarkohen të gjitha bankat, degët e bankave të huaja dhe zyrat e këmbimit valutor të pranojnë për këmbim, deri në datën 31.12.2023, kartëmonedhat pa kurs ligjor sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, dhe t'i dërgojnë ato menjëherë pranë Bankës së Shqipërisë dhe degëve të saj.

3. Ngarkohet Departamenti i Emisionit dhe Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës me zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit European dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 15.3.2013
Doli nga shtypi më 15.3.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 28 lekë